



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E  
TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 605/6 prot.

Tiranë më 03.05.2024

**VENDIM**

**Nr. 09, datë 03.05.2024**

**PËR KONTROLLUESIN**

**PËR KONTROLLUESIN “DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE  
DHE KOPSHTEVE”**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve” (në vijim, “Kontrolluesi ose D.P.Ç.K”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 57, datë 29.02.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve është institucion vendor, person juridik publik, në varësi të Bashkisë së Tiranës dhe ushtron aktivitetin e tij në lidhje me zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve nëpërmjet çerdheve dhe kopshteve të vendosura në njësi të ndryshme administrative. D.P.Ç.K. funksionon në zbatim të

Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 01.07.2004, Vendimit nr. 987, datë 10.01.2022 dhe Urdhrit nr. 52, datë 19.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

D.P.Ç.K organizon dhe ndjek procedurën e aplikimeve për regjistrimin e fëmijëve në çerdhet dhe kopshtet publike të Bashkisë Tiranë. Sipas urdhrit nr. 444, datë 16.05.2023 *“Për procedurën e aplikimeve zyrtare, për regjistrimin e fëmijëve në çerdhet dhe kopshtet publike të Bashkisë Tiranë”*, sezoni 2023-2024 dhe relacionit nr. 562/2, datë 02.06.2023 është organizuar procedura dhe administruar dokumentacioni përkatës i depozituar gjatë aplikimeve.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve *“fëmijë”*, *“prindër/kujdestar ligjor”*, *“punonjës”*. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. D.P.Ç.K në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 158, datë 26.12.2019 *“Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”* ofron shërbimin pa pagesë, për fëmijët që i përkasin familjeve të disa kategorive të përcaktuara, të tilla si: familjet në nevojë, fëmijët me aftësi të kufizuar, etj. D.P.Ç.K administron të gjitha dokumentet provuese të fëmijëve, të cilët përfitojnë rimbursim të plotë të tarifës për regjistrimin dhe ndjekjen e ciklit të ofruar në çerdhet dhe kopshtet publike të Tiranës, si më poshtë vijon:

- Libreza e statusit jetim të fëmijës;
- Certifikata personale dhe familjare e fëmijës;
- Vërtetimi për frekuentimin e çerdhes ose kopshtit;
- Raporti mjeko-ligjor i fëmijës;
- Vërtetim nga Njësia Administrative për trajtimin me ndihmë ekonomike të kujdestarit ligjor;
- Vërtetim page i kujdestarit ligjor i cili duhet të jetë në/nën vlerën minimale të pagës në Republikën e Shqipërisë;
- Kartela personale e punëkërkuarit (nga zyra rajonale e punësimit);
- Vërtetim nga Zyra e Tatim-Taksave që nuk ka aktivitet privat;
- Vërtetim përkatës të lëshuar nga organizatat që mbrojnë të drejtat e tyre ose vetëdeklarimit ku përcaktohet se familja është pjesë e pakicës rome dhe egjiptiane;
- Vendime të Gjykatës ku fëmija është vendosur në kujdestari nga familjet kujdestare.

Njëkohësisht, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 116, datë 27.09.2018 *“Për mbështetjen financiare të nxënësve me arritje të shkëlqyera në shkollat publike të Bashkisë Tiranë”*, D.P.Ç.K ofron mbështetje financiare për nxënësit me arritje të shkëlqyera që ndjekin arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë në shkollat publike të qarkut të Tiranës. Kontrolluesi, për përfitimin e mbështetjes financiare për nxënësit me arritje të shkëlqyera, administron dokumentacion, si më poshtë vijon:

- Fotokopje e noterizuar e dëftesës së vitit shkollor;
- Vërtetim nga drejtoria e shkollës për vazhdimin e vitit shkollor;
- Certifikatë personale me fotografi e tre muajve të fundit;
- Certifikatë e gjendjes familjare.

Rezulton se, në datë 28.02.2024, nga burime të ndryshme informacioni dhe media audio-vizive, në zonën e Alliasit Tiranë, janë hedhur në vende publike, dosje dhe dokumente, në përmbajtje të cilave gjenden, ndër të tjera, dhe informacione mbi të dhënat personale të subjekteve të lartpërmendur.

Nga verifikimi në vend dhe nga administrimi i provave konstatohet se, të dhënat i përkasin institucioneve arsimore si: çerdheve, kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare, përkatësisht të viteve 2011-2019 dhe konsistojnë në: *“certifikatë familjare, certifikatë personale, raport mjeko-ligjor, vërtetim banimi, vërtetim nxënësi, kartela personale e punëkërkuarit, fotografi, vërtetime tatimesh, dëftesë (origjinale dhe e noterizuar), kartelë personale e të punësuarit, vërtetim frekuentimi kopshti, kopje kartës së ID, vërtetim për sëmundje të përgjithshme, vendim për rikontroll të invalidëve, vërtetim page, lista emërore e nxënësve, kopje dëftese, vërtetim noterial”*.

Gjithashtu, rezulton se, ndër provat e administruara, ndodhen dhe fatura arkëtimi të D.P.Ç.K-së, të lëshuara për çerdhet dhe kopshtet, për përfitimin e stimujve financiarë, të cilat provojnë se dokumentacioni i disponuar nga Kontrolluesi, korrespondon me dokumentacionin e përhapur në ambientet publike. Këto të dhëna, përkojnë në vite dhe në përmbajtje me kategoritë e të dhënave që Kontrolluesi përpunon dhe administron në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të legjislacionit specifik.

Në vijim të hetimit administrativ, përfaqësuesit e D.P.Ç.K-së deklaruan se dokumentacioni i përhapur i viteve të hershme, ka qenë nën administrimin e këtij institucioni. Për këtë arsye, Kontrolluesi pretendon se i ka deleguar procedurën e shkatërrimit, Komisionit të Ekspertizës, si struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe asgjësimin e dokumentacionit të prodhuar. Megjithatë, rezulton se, procedura e asgjësimit të të dhënave nuk është kryer dhe dokumentacioni me të dhënat respektive është nxjerrë i pashkatërruar nga ambientet e Kontrolluesit, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Grupi i hetimit administrativ, pas verifikimit të procedurës së shkatërrimit të të dhënave personale, konstaton se, Kontrolluesi nuk ka zbatuar procedurën e përcaktuar në nenin 25 të *“Rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”* nr. 1349/2, datë 15.11.2023 të D.P.Ç.K., për asgjësimin e dokumentacionit që përmban të dhëna personale të subjekteve të të dhënave.

Për sa më sipër, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht në këtë rast kur përpunimi i të dhënave

personale ka në përmbajtje të tyre të dhëna sensitive, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”*, (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, të natyrës së veprimtarisë që ushtron, Kontrolluesi, është i detyruar të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

3. Konstatohet se, nga provat e administruara dhe nga verifikimi në vend, lidhur me kategoritë e të dhënave të përpunuara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi ruan dosjet me të dhënat e nxënësve në tejkallim të qëllimit për të cilin ato janë grumbulluar, në kundërshtim me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi ka detyrim të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar dhe në momentin e përfundimit të qëllimit, duhet të realizojë shkatërrimin e tyre, në të kundërt, përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave.

4. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, konstatohet mosplotësim i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit së Sigurisë së Informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr. 47.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me nenin 27 të Ligjit dhe parashikimet e Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Gjithashtu, sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Udhëzimit nr. 47, trajnimet e stafit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura, sipas nevojave dhe proceseve të punës së Kontrolluesit, me qëllim ndërgjegjësimin e operatorëve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës. Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit u paraqit në seancën dëgjimore, ku pranuan konstatimet e grupit të hetimit të reflektuara në procesverbalin e hetimit administrativ dhe nuk paraqitën kundërshtime.

Konkretisht, përfaqësuesit e Kontrolluesit, ndër të tjera, u shprehën se, *“Jemi njohur me të gjitha konstatimet e grupit të kontrollit, në takimet e mëparshme kemi vendosur në dispozicion të gjithë dokumentacionin, ku provohet arsyeja se përse D.P.Ç.K administron dokumentacionin objekt hetimi. D.P.Ç.K është e ndërgjegjshme se mekanizmat e kontrollit të institucionit kanë ceduar dhe kemi pasur një mungesë në mekanizmat e asgjësimit të dokumentacionit, të cilit i ka përfunduar qëllimi i grumbullimit. Megjithatë, vlerësojmë të theksojmë se dokumentacioni i përhapur, nuk janë dokumente arkivore, por janë materiale të vjetra, kryesisht materiale mbështetëse, të cilat nuk janë asgjësuar në mënyrën e duhur. Pranojmë se kemi nevojë të trajnohemi në vijim lidhur me masat e sigurisë”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi në mënyrë të vazhdueshme duhet të marrë masa të përshtatshme teknike dhe organizative gjatë përpunimit të të dhënave sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave personale.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a” dhe “dh” të pikës 1, të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2, të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara dhe pasojat janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale.

## PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 27, 29, 30, 39 pika 1, germat “a”, dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

### V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenet 27 dhe 28 të Ligjit;
- 3- Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
- 4- Kontrolluesi, të marrë masa konkrete, për zbatimin e procedurës së asgjësimit të të dhënave personale që kanë humbur qëllimin e përpunimit, në përputhje me nenin 27 të Ligjit;
- 5- Kontrolluesi, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, të marrë masa për përditësimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit, procedurat për asgjësimin e të dhënave personale etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
- 6- Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, si dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
- 7- Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:
  - i. vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 3 dhe 4 më sipër;
  - ii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 5 më sipër;
  - iii. brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 6 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

- 8- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

**9-** Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;

**10-** Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 03.05.2024.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**